

GUIDA EKSPORTI

GREQIA



GUIDA EKSPORTI – SERBIA

1. PËRMBLEDHJE E VENDIT

1.1 Treguesit e Përgjithshëm Ekonomikë

TREGUESI	VLERA (2023)
PBB NOMINAL	224 billion €
PBB PËR FRYMË	36.267 €
POPULLSIA	10.4 milionë
SHKALLA E RITJES EKONOMIKE	2.1 %
NORMA E PAPUNËSISË	11.7%
INFLACIONI	6.7 %
BORXHI PUBLIK	163.9 % e PBB-së

1.2 Hapja ndaj Tregtisë (Raporti Tregti-PBB)

65 % Raporti Tregti – PBB	107.7 MLD € Eksportet totale	70 MLD € Importet totale
* Vlera (2023)	* Vlera (2023)	* Vlera (2023)

Industritë dhe sektorët kryesorë të Greqisë janë turizmi, transporti, energjia, TIK, agrikultura. Pjesë e madhe e eksporteve drejtohen drejt BE-së, konkretisht drejt Italisë, Bullgarisë, Gjermanisë.

2. ANALIZA E TREGUT

2.1 Statistikat e Import-Eksportit

						
Minerale	Metale	Produkte Kimike	Makinieri dhe Paisje	Ushqime dhe Pije	Tekstile	Produkte Plastikë
EKSPORTET (€ MILIARDË)						
37.2	11.2	10.5	9.5	9.1	3.8	3.5
IMPORTET (€ MILIARDË)						
35.9	12.7	20.7	23.8	8.7	6.9	6.7

Greqia eksporton kryesisht produkte minerale. Shumica e mallrave të saj gjatë vitit 2023, u eksportuan në Itali.

2.2 Partnerët Kryesorë Tregtarë

				
Italia	Bulgaria	Gjermania	Kina	Turqi
EKSPORTET (\$ MILIARDË)				
12.6	7.5	7.2	-	3.7
IMPORTET (\$ MILIARDË)				
5.5	-	17.9	14.9	5.9

3. OBJEKTIVAT E EKSPORTIT

3.1 Qëllimet

- Rritja e eksporteve drejt Greqisë është pjesë e një strategjie më të gjerë për të forcuar marrëdhëniet ekonomike në kuadër të nismave rajonale.
- Shqipëria synon të rrisë llojet e produkteve që eksporton drejt Greqisë, duke përfshirë mallra me vlerë të shtuar dhe produkte përpunuese.
- Përveç produkteve si minerale, tekstile dhe metale, Shqipëria duhet të rrisë eksportet për produktet bujqësore dhe materialeve të ndërtimit.
- Forcimi i imazhit të produkteve shqiptare në tregun grekë, për të krijuar një bazë të qëndrueshme konsumatorësh.

3.2 Strategjia e Hyrjes në Treg

- Bashkëpunimi me distributorë lokalë.
- Shitje direkte dhe pjesëmarrje në tregjet online (platforma e-commerce).
- Përdorimi i rrjetëzimeve B2B dhe panairove tregtare në Greqi.

4. MUNDËSITË PËR BIZNESET SHQIPTARE

 BUJQËSIA DHE USHQIMET Greqia importon një shumëllojshmëri produkt - esh bujqësore, si vaj ulliri i cilësisë së lartë, fruta-perime, duke paraqitur mundësi për eksportuesit shqiptarë.	 TEKSTILE Tregu grek ka kërkesë për produkte tekstile-këpucë cilësore	 MINERALE DHE PRODUKTE NATYRORE Kërkesë në rritje për produkte si naftë, krom, hekur, plumb, zink dhe nikel
---	---	---

5. RREGULLORET DHE BARRIERAT TREGTARE

5.1 Tarifat Doganore dhe Importit

- Si një anëtare e BE-së, Greqia zbaton Tarifën e Përbashkët të Jashtme për vendet joanëtare të BE-së; megjithatë, Shqipëria përfiton nga marrëveshjet tregtare preferenciale me BE-në, duke ulur ose eliminuar potencialisht disa tarifa

5.2 Barrierat Jotarifore

- Certifikimi dhe standardet: Pajtuueshmëria me standardet e BE-së është e detyrueshme, duke përfshirë rregulloret e shëndetit dhe sigurisë.
- Çështjet logjistike: Rrjetet efikase të transportit dhe shpërndarjes janë thelbësore për të siguruar shpërndarjen në kohë.

6. AKTORËT DHE PARTNERËT KRYESORË



AIDA

Mbështetje për
eksportuesit shqiptarë



**MINISTRIA GREKE E
ZHVILLIMIT
DHE INVESTIMEVE**

Mbikëqyr zhvillimin tregtar
dhe ekonomikë



**AUTORITETI STATISTIKOR
HELEN (ELSTAT)**

Ofron të dhëna
statistikore zyrtare



**FEDERATA HELENIKE
E NDËRMARRJEVE
(SEV)**

Lidhje biznesi



**DHOMA E TREGTISË DHE
INDUSTRIË E ATHINËS
(ACCI)**

Mbështet aktivitetet e
biznesit në rajonin e Athinës



**HELLENIC EXPORT
PROMOTION ORGANIZATION
(HEPO)**

Mbështet NVM për zhvillimin
dhe zgjerimin e tregjeve



**HELLENIC FOOD AUTHORITY
(EFET)**

Agjencia e Mbrojtjes
së Ushqimit



**CENTER FOR RENEWABLE
ENERGY SOURCES
AND SAVING**

Qendra për Burimet e
Rinovueshme të Energjisë
dhe Kursimin



**GREEK FUND FOR
ENTREPRENEURSHIP
AND DEVELOPMENT**

Mbështet financiarisht
NVM për zhvillimin

7. AKTIVITETE PROMOVUESE

- Food Expo Greece: Një ngjarje e madhe për sektorët e ushqimit dhe pijeve. Panairi ka në fokus produktet e bulmetit, brumit, vajit të ullirit, pije të ndryshme, produktet me origjinë shtazore, organike, produktet me emërtim të mbrojtur të origjinës (PDO), ushqime, perime të ngrira, salcë, lëngje, pije freskuese, ushqime të gatshme, etj. <https://foodexpo.gr/en/exhibition/exhibitor-categories/>
- Panairi Ndërkombëtar i Selanikut, është ekspozita kryesore e teknologjisë dixhitale në Evropën Juglindore, Mesdhe, e cila i dedikohet sektorit të sipërmarrjes dhe inovacionit. Pjesëmarrja në këtë ekspozitë, do t'u mundësojë kompanive shqiptare njohjen me partnerë ndërkombëtarë në fushat e transformimit dixhital, pjesëmarrje në konferenca dhe workshope që lidhen me sektorin e Start-Up, në mënyrë që të fitojnë një përvojë unike interactive që kjo ekspozitë ofron. <https://www.beyond-expo.gr/>

8. MUNDËSITË PËR RRJETËZIM B2B

- Aktivitet e Dhomës Greke të Tregtisë.
- Misionet Tregtare të organizuara nga agjencitë tregtare shqiptare (AIDA, Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë Shqiptare, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë)
- Platformat e tregtisë elektronike dhe iniciativat e tregtisë virtuale
- Skrutz.gr: Platforma më e madhe e tregtisë elektronike në Greqi, që ofron mundësi për të ekspozuar produktet shqiptare drejtpërdrejtë tek konsumatorët grekë.
- Platformat Ndërkombëtare: Përdorni platforma globale si Amazon dhe eBay, të cilat kanë një prani në Greqi, për të arritur një audiencë më të gjerë.
- Virtual Trade Show: Ekspozita online të organizuara nga shoqatat e industrisë dhe dhomat tregtisë në Greqi.

8. ANALIZA SWOT

FAKTORËT	PIKAT POZITIVE	SFIDA
PIKAT E FORTA	Afërsia gjeografike e Shqipërisë me Greqinë redukton kostot e transportit dhe kohën e dorëzimit	Marrëveshjet tregtare preferenciale ndërmjet Shqipërisë dhe BE-së, përfshirë Greqinë, lehtësojnë aksesin në treg.
DOBËSITË	Ndërgjegjësim i kufizuar: produktet shqiptare mund të kenë njohje të ulët të markës në Greqi. Konkurrenca e tregut: prodhuesit grekë dhe eksportuesit e tjerë të BE-së ofrojnë konkurrencë të fortë	Sigurimi i pajtueshmërisë me rregulloret e BE-së
MUNDËSITË	Kërkesë në rritje për produkte organike dhe të specializuara ofron mundësi për mallra unike shqiptare. Fluksi i lartë i turistëve në Greqi krijon një kërkesë për produkte ushqimore dhe suvenire me cilësi të lartë	Shqipëria mund të shfrytëzojë tregjet e produkteve të gjelbërta në Greqi
KËRCËNIMET	Paqëndrueshmëria ekonomike globale mund të ndikojë në kapacitetin importues të Greqisë	Inflacioni dhe kostot e lëndëve të para

10. REKOMANDIME

- Greqia mbetet një nga tregjet më tërheqëse për eksportuesit shqiptarë, por ata përballen me sfida si standardet e rrepta të cilësisë, konkurrencën nga prodhuesit më të vendosur dhe nevojën për një strategji të fortë marketingu për të fituar besimin e blerësve grekë.
- Investimi në çertifikata (organike, HACCP, ISO) për të rritur tërheqjen e produktit shqiptarë.
- Duhet të forcohet markimi dhe strategjitë e diferencimit.
- Rekomandohet mundësi bashkëpunimi me shpërndarësit dhe shitësit grekë për të hyrë në tregun vendas.
- Qasja me partnerë dhe rrjetëzimi B2B.

GUIDA EKSPORTI

GREQIA